- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Oferta ekonomike e detajuar**

<b>Nr.</b>	<b>Nr. Analizë</b>	<b>Përshkrimi i Punëve</b>	<b>Njësi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi/ Njësi</b>	<b>Cmimi total</b>
1.		Sipas Preventivit të punimeve (Shtojca 10)	Komplet	1		
<b>Shuma</b>						
<b>Fondi Rezervë</b>						
<b>Shuma</b>						
<b>TVSH</b>						
<b>SHUMA TOTAL</b>						

**Nënshkrimi i ofertuesit** \_\_\_\_\_

**Vula**

**Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

**Shtojca 3.**

---

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**



## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

#### Riparimi i linjes Kabllore 110 kV Nst. Kombinat – Nst. Selite, faza e dyte

#### Permbajtja

1.	Përshkrime të përgjithshme.....	17
1.2.	Te dhena teknike .....	18
1.3.	Standartet .....	18
2.	Linja kabllore 110 kV.....	19
2.2.	Rryma nominale e linjes .....	19
2.3.	Rrymat e Lidhjes se Shkurter .....	19
2.4.	Tokezimi I skermos se kablllove .....	19
2.5.	Ndertimi I kanalit te kablllove .....	19
2.6.	Projektimi I pusetave te xhuntimit.....	Error! Bookmark not defined.
2.7.	Aksesoret.....	20
2.7.1.	Xhuntot per kabllot 110kV .....	21
2.7.2.	Kabllot e lidhjes dhe kabllot paralele të tokëzimit.....	21
3.	Kerkesat teknike per paisjet dhe materialet (data sheets) .....	22

#### 1. Përshkrime të përgjithshme

Qëllimi i këtij investimi është riparimi i linjes kabllore 110kV Kombinat – Selite e cila ka pësuar demtim të sajë në një fazë, përkatësisht Faza B.

Nepërmjet këtij projekti synohet riparimi i fazes B të demtuar duke realizuar përkatësisht 2 muftë dhe nderrimin e kabllit në një segment prej 15 ml. Nga pika e demtimit është parashikuar zëvendësimi i kabllit deri në një distancë të përafërt prej 7.5 ml për pozicionimin e muftëve 110 kV në të dy drejtimet. Në këtë segment kablli i fazes B do të nderrohet dhe në 2 ekstremet do të realizohen përkatësisht muftet 110 kV.

Duhet të furnizohen materialet dhe të kryhen punimet si më poshtë :

- |    |  |        |
|----|--|--------|
| a. | Muftë 110 kV dhe instalimi tyre                                | cope 2 |
| b. | Punime civile për hapjen e kanalit të kabllit 110 kV           | ml 15  |
| c. | Percaktimi i kabllit të demtuar dhe demontimi tij              | ml 15  |
| d. | Shtrirja e kabllit të ri në të njëjtin pozicion me ekzistuesin | ml 15  |
| e. | Kthimin në gjendjen fillestare                                 |        |

Kablli 110 kV i cili do të përdoret për zëvendësimin e kabllit të demtuar do të furnizohet nga OST sh.a.

## 1.2. Te dhena teknike

Tabela e mëposhtme përshkruan kushtet e përgjithshme në të cilat kabloja dhe Aksesorët shoqërues të kabllove duhet të jenë në gjendje të punojnë pa asnjë degradim:

Nr.	Parametrat	Performanca
1	Jetegjatesia e projektit	40 vjete
2	Gjendja e neutrit	Tokezim solid
3	Tensioni nominal i sistemit	110kV
4	Tensioni Faze – toke	64 kV
5	Tensioni maksimal	123 kV
6	Qendrueshmeria ndaj tensionit impulsiv	550 kV
7	Rrymat e Lidhjes se shkurter 3 fazore	25 kA per 1s
8	Rrymat e Lidhjes se shkurter 1 fazore	25 kA per 1s

## 1.3. Standartet

- IEC 60840: Power Cables with extruded insulation and their accessories for rated voltages up to 150kV ( $U_m = 170kV$ ) – Test methods and requirements
- HD 632.2 2008: Power cables with extruded insulation and their accessories for rated voltages above 36 kV ( $U_m = 42 kV$ ) up to 150 kV( $U_m = 170 kV$ )
- IEC 60228: Conductors of insulated cables
- IEC 60229: Tests on cable oversheaths which have a special protective function and are applied by extrusion
- IEC 60811: Common test methods for insulating and sheathing materials of electric cables
- IEC 60287: Electric cables – Calculation of the current rating
- IEC 60853: Calculation of the cyclic and emergency current rating of cables
- IEC 949: Calculation of thermally permissible short-circuit currents, taking into account non-adiabatic heating effects
- CIGRE Technical Brochure No. 272 – Large cross sections and composite screens design
- ENA-ER-C55/4: Insulated Sheath Power Cable Systems
- BS EN 206-1:2000 Concrete Part 1: Specification, performance, production and conformity
- BS EN 124:1994 Gully tops and manhole tops for vehicular and pedestrian areas. Design requirements, type testing, marking, quality control.
- IEC 60794-1-1: Optical fiber cables. Generic specification. General
- IEC 60794-1-2: Optical fiber cables. Generic specification. Basic optical cable test procedures
- IEC 60793-1-1: Optical fibers. Measurement methods and test procedures. General and guidance
- ITU G.652: Characteristics of a single-mode optical fiber cable

- 
- IEC 61753-1 Fiber optic interconnecting devices and passive components performance standard
  - Telcordia GR -326: Generic Requirements for Single-Mode Optical Connectors and Jumper Assemblies

## **2. Linja kabllore 110 kV**

### **2.2. Rryma nominale e linjes**

Linja ekzistuese kabllore eshte ndertuar me kablllo me izolacion XLPE me seksion  $1000 \text{ mm}^2$  te vendosur drejtperdrejt ne toke ne nje thellesi 1.1 ml dhe ne nje gjeresi kanali 0.8m me kablllo te vendosur ne kontakt. Rryma nominale e linjes sipas dokumentacionit te linjes eshte 750A per kushtet e me poshteme:

- Temperature e tokes  $20^{\circ}\text{C}$
- Rezistenca termike tokes:  $1 \text{ K.m/W}$

### **2.3. Rrymat e Lidhjes se Shkurter**

Qarku i tokëzimit përbëhet nga skermo/ekranet metalike të kabllit 110 kV, kabllot lidhëse, kabllot e tokëzimit dhe aksesorët përkatës, janë projektuar, prodhuar dhe instaluar për të siguruar pa asnjë degradim perballimin e rrymës së nevojshme të lidhjes së shkurtër njëfazore: 25 kA për kohëzgjatje prej 1 s.

Materialet e reja qe do te instalohen duhet të projektohet dhe prodhohet për perballimin e rrymave te qarkut të shkurtër njëfazor të përmendur më sipër.

### **2.4. Tokezimi I skermos se kablllove**

Në mënyrë që te ruhet regjimi i punes dhe skema aktuale e tokezimit te skermos se kablllove ne muftet e reja do te sigurohet vazhdimësia e skermos se kabllit 110 kV. Bashkimi do te behet me gilza me seksione te pershtateshme per perballimin e rrymave te LSH deri 25 kA.

### **2.5. Ndertimi I kanalit te kablllove**

Gërmimi i kanaleve do të planifikohet në një mënyrë për të minimizuar ndërprerjet dhe kufizimet e aksesueshmërisë. Punimet e ndërtimit do të kryhet në përputhje me legjislacionin e Sigurise dhe mbrojtjes se mjedisit. Zona ku do te kryhen punime eshte zone me infrastrukture te renduar nentokesore per kete qellim punimet do te organizohen me krahe dhe makineri. Shtresat asfaltike do te prishen me makineri dhe me pas germimi do te vazhdoje me krahe.

Në rast se demtohet infrastrukture ekzistuese nëntokësore, përkatësisht kabllot e energjisë, kabllot e telekomit, tubacione gazi, tubacione uji dhe infrastrukture te cdo lloi tjeter, Kontraktori do të përpqet të riparojë menjëherë demet e shkaktuara. Për më tepër, Kontraktori do të jetë përgjegjës për humbjet e shkaktuara nga ndërprerjet që rezultojnë nga dëmet e shkaktuara nga Kontraktuesi.

Gjerësia totale e kanalit duhet të jetë e mjaftueshme për:

- Mbrojtjet e nevojshme për muret e kanalit;
- Hapësira horizontale shtesë e kërkuar për lëvizshmërinë e punëtorëve dhe sigurinë.

Rrezja minimale e përkuqjes për kanalet përgjatë rrugës së kablllove, duhet te jete në përputhje me kërkesat e prodhuesit të kablllove dhe presionit maksimal ne muret anësore por ne asnje rast me e vogel se 2.7 m.

Dheu qe përdoret për të mbushur kanalit nuk duhet të ketë materiale organike, argjilë dhe gurë. Duhet te zgjidhet një kombinim adekuat te madhësisë së kokrrizave dhe ngjeshjes në mënyrë që të përputhet me rezistencën termike të mbushjes së kërkuar për vlerësimin e performances se kablllove.

---

Mbushja duhet të jetë e përshtatshme për të perballuar:

- qendrueshmerine mekanike te trasese se kablllove,
- nenkalimet dhe mbikalimet e infrastruktures ekzistuese,
- rrjedhat ujore,
- erozioni i tokës dhe rrëshqitjet e dheut.

Pas mbushjes së kanalit, duhet të rivendoset sipërfaqe origjinale e rrugës si dhe çdo zonë e dëmtuar gjatë procesit të ndertimit.

Të gjitha mbetjeve nga procesi ndertimit, dhe trajtimi do të kryhet në përputhje me legjislacioni local ne fuqi.

Ne project jepet gjurma e kabllit ekzistues. Perpara fillimit te punimeve duhet te behet sondazhe me qellim verifikimin ekzakt te gjurmes se kabllit, pozicionit te fibres optike ne kanal dhe thellesise se kablllove me qellim zvogelimin e rrezikut te demtimit te infrastruktures ekzistuese.

***Para fillimit te punimeve do te rikryhet testim i linjes kabllore me qellim konfirmimin e fazes se demtuar, gjendjes se fazeve te tjera dhe pozicionit te demtimit.***

Pas instalimit te xhuntove mbi kabllin do të aplikohen provat e mëposhtme:

- Prova me megër minimalisht 2500V
- Prova me tension te lartë të rrymës së vazhduar
- Prova me tension alternativ perpara venies ne shfrytezim

Provat e mësipërme do të ekzekutohen në përputhje me IEC 60840 dhe IEC 60502.

## **2.6. Aksesorët**

Xhuntot për kabllo 110 kV duhet të jenë të realizuara në menyrë të tillë që, të ofrojne cilësitë më të mira të teknologjisë për polimeret që tkurren në nxehtësi dhe atë prej silikoni me forma të parapërgatitura dhe të derdhura që në fabrikë si dhe të kombinuar me eksperiencën e karakteristikave të materialeve me afat të gjatë kohor nën tension dhe veprimin e ambjentit të jashtëm.

Parimet bazë të teknologjisë së kërkuar për këto xhunto dhe terminale 110 kV janë:

### **Izolimi kryesor të jetë i para-derdhur**

Të realizojë uniformizimin e fushës elektrike dhe të ofrojë:

- diapazon të gjerë aplikimesh
- instalim të lehtë dhe të mos kërkojë pajisje tërheqëse

**Lidhjet me ekranet metalike të kabllit duhet te realizohen ne menyre te tille qe keto lidhje te :**

- Mos përbejnë rrezik për dëmtimin e kabllit
- Të realizojnë instalim të lehtë
- të krijojnë adoptim të lehtë në kabllot me dy ose me shume shtresa mbrojtëse

### **Sistemi i jashtëm hermetizues duhet të jetë me termotkurrje**

Sistemi i jashtëm hermetizues duhet të jetë me termotkurrje dhe keto polimere me lidhje të kryqezuar me termotkurrje dhe me mastike hermetizuese të termoshkrirshme duhet të realizojnë :

- izolim të sigurtë ndaj lagështisë
- mbrojtje mekanike e trupit të xhuntos

---

### 2.6.1. Xhuntut per kabllo 110kV

Ky specifikim mbulon bashkueset (muftet) e kabllove 110 kV (bëj kujdes se sistemi i tensioneve është 64/110/123 kV), me përcjellës alumini 1000 mm<sup>2</sup> me izolim XLPE.

#### **Kriteret e projektimit të xhuntove dhe materialet që përdoren**

Konstruksioni i xhuntos duhet të jetë projektuar në mënyrë të tillë që të rikostitujë nga pikëpamja elektrike dhe mekanike ndërtimin e vete kabllit. Rrjeta e bakrit që përdoret si skermë dhe që mbulon të gjithë trupin e xhuntos duhet të jete jo më e vogël se 95 mm<sup>2</sup>.

Skerma e xhuntos duhet të lidhet në mënyrë solide me skermën e kabllit.

Palltoja e jashtme që aplikohet mbi xhunton pas përfundimit të saj duhet të jetë krejtësisht hermetike që të sigurojë një izolim të plotë të izolacionit të kabllit dhe muftes, si dhe pikave të tyre bashkuese nga ambienti i jashtëm. Ajo gjithashtu duhet të jetë mekanikisht e qëndrueshme ndaj goditjeve dhe sforcimeve mekanike, si dhe rrezatimit ultraviolet. Përcjellësit e kabllit në të dy skajet duhet të bashkohen me gilza që duhet të jenë plotësisht në përputhje me kërkesat e standartit IEC -1238-1 .

E gjithë xhuntoja duhet të kënaqë kërkesat e standartit IEC 60 840.

Xhuntut duhet të jenë të projektuara për tension nominal 110 kV në sistemin elektrik me të dhënat e paraqitura në paragrafin 1.

Xhuntut duhet të jenë të konstruktura në mënyrë të tillë që të plotësojnë këto kërkesa:

- Xhunto duhet të jetë e parafabrikuar si dhe të jenë të testuara në fabrikë.
- Lidhja elektrike e dejeve duhet të realizohet me bullona përcjellës me përdredhje të kontrolluar
- Duhet të ketë të integruar një sistem me termokurrje i cili të bllokojë depertimin papastërtive dhe lageshtisë
- Të ofrojë dimensione të vogla dhe hapje të vogël të vendit të punës.
- Pjesët përbërëse prej silikoni të parafabrikuar duhet të jenë të testuara në fabrikë

Konstruksioni i xhuntos duhet të përmbajë konektorin bashkues, konin për uniformizimin e fushës elektrike dhe trupin e xhuntos si dhe duhet të ketë të realizuar « kafazin e Faradeit » në të, si dhe sistemin e hermetizimit që duhet të jetë i realizuar me teknologjinë me termokurrje.

Lidhja elektrike e përcjellësve të kabllit duhet të realizohet me anën e konektorëve me vide të kontrolluar në përdredhje. Këto lloj konektorësh duhet të jenë të përshtatshëm për përcjellësat e përdredhur prej alumini ose bakri dhe të mund të modifikohen për të pranuar gjithashtu aplikimin në to edhe të përcjellësve solid të kabllove.

Uniformizimi i fushës duhet të realizohet nga koni prej silikoni dhe ky duhet të sigurojë kontrollin e fushës elektrike si dhe duhet të instalohet lehtësisht falë elasticitetit të tij shumë të mirë.

Lidhjet elektrike dhe ato të ekranit duhet të realizohen pa saldim.

Hermetizimi i jashtëm duket të realizohet me anën e sistemeve hermetizuese me termokurrje dhe ngjitje të cilat duhet të garantojnë një hermetizim pefekt dhe padepertueshmëri të lagështisë apo papastërtive brenda trupit të xhuntos.

#### **Testimi**

Testimi i Xhuntove në kabllo 110 kV duhet të behet në përputhje me standartet IEC 60840 dhe IEEE 404. Ofertuesi duhet të dorëzojë një raport të plotë testimi për provat e tipit të muftëve 110 kV që do të ofrojë. Raporti duhet të jetë një raport i testimit të muftëve identike me ato që do të livrohen në këtë kontratë. Raporti duhet të përmbajë të dhënat e plota të dala nga testimi dhe ai duhet të jetë konceptuar dhe hartuar në përputhje me kërkesat e standartit kodifikues Cenelec 629 1S1.

Cdo mufte duhet të nënshtrohet provave rutine, si qëndrueshmërisë ndaj tensionit alternativ 50 HZ për një orë, si dhe rezistencës së xhuntove nën ujë, në mjegull në ujë të kripur apo ndonjë provë tjetër speciale, gjithmonë në përputhje me provat speciale të parashikuara në standartin IEC.

Punëmarrësi duhet të furnizojë gjithë materialin e nevojshëm për të kryer vendosjen në punë të kabllit si mishelë izolante etj.

### 2.6.2. Kabllot e lidhjes dhe kabllot paralele të tokëzimit

Kabllo e lidhjes dhe kabllo paralele duhet të projektohen, prodhohen dhe instalohen për të perballuar rrymat e qarkut të shkurtër të përshkruar në kete projekt pa asnjë degradim fizik.

Seksioni terthor minimal i bakrit për kabllo e lidhjes me një bërthamë dhe kabllo paralele të tokëzimit duhet të jenë  $1 \times 120 \text{ mm}^2$ . Percjellesi i bakrit duhet të jetë në përputhje me IEC 60228 klasa 2 (compacted).

Për kabllo e lidhjes se skermos, seksioni terthor minimal prej bakri duhet të jetë  $2 \times 120 \text{ mm}^2$ .

### 3. Kerkesat teknike per paisjet dhe materialet (data sheets)

<i>Te dhenat teknike (Technical Data Sheets - 110 kV Underground Lines)</i>				
Nr.	Pershkrimi	Kerkesat minimale		Te ofertuarat
		Njesi	Vlera	Vlerat
<b>1</b>	<b>Te pergjitheshme</b>			
	Tensioni me i larte i sistemit	kV/Hz	123/50	
	Tensioni Nominal	kV	110	
	Qendrueshmeria ndaj tensionit impulsive	kV, peak	550	
	Qendrueshmeria ndaj tensionit me frekuence industriale	kV, r.m.s	160	
	Sistemi i neutrit	-	Tokezim solid	
<b>2</b>	<b>Parametrat kryesore te projektimit</b>			
	Temperatura e tokes ne thellesine e vendosjes se kabllit	°C	+20	
	Rezistenca termike e tokes	K.m/W	1.2	
<b>3</b>	<b>Muftet 110 kV</b>			
	Tipi		Parafabrikuar	
	Tensioni ( $U_0/U (U_m)$ )	kV	64/110 (123)	
	Lidhja e percjellesit	--	Gilza me shtrengim	
	Seksioni i percjellesit	mm <sup>2</sup>	1000	
	Percjellsi per lidhjen e skermos		CU fleksibel 2x120mm <sup>2</sup>	
	Qendrueshmeria ndaj tensionit impulsiv	kV	550	
	Qendrueshmeria ndaj tensionit me frekuenc industriale test (30 min)	kV	160	
	Shkarkesat maksimale te testuara na $1.5 \times U_0$	pC	5	

#### Shënime:

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.
- ii. Kudo ne Specifikiet Teknike ku eshte cituar standard nderkombetar, do te pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.

---

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/ kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE**

**Afatet e realizimit të punimeve: 2 (dy) muaj nga hyrja ne fuqi e kontrates.**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3. Afati i realizimit</i>				
<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i Punëve</b>	<b>Java 1/Muaji 1</b>	<b>Java 2/Muaji 2</b>	<b>Java 3/Muaji 3</b>	<b>Java 4/Muaji 4</b>	<b>Java 5/Muaji 5</b>
1.						
2.						
3.						
4						

Shënim. Autoriteti/ kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

#### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.



- 
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

*Sipas pikes 1 te kesaj shtojce.*

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 1,000,000 (një milion) Leke.*

*Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

*Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.*

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet te ketë realizuar të paktën:*

a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 700,000 (shtatëqind mijë) Leke dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*

b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më të vogël se 2,500,000 (dy milion e peseqind mijë) Leke.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE Ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, OE Ofertues duhet të paraqesë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me licence profesionale, ne fushen e zbatimit te punimeve, leshuar nga organet perkatese, e cila te permbaje kategorite e meposhtme:*

Punime te pergjithshme ndertimi:

Kategoria NP-1	Punime germimi ne toke	Klasifikim A
Kategoria NP-2	Ndertime civile dhe industriale	Klasifikim A
Kategoria NP-11	Ndertime per N/Stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e te mesme dhe shperndarjen e energjise	Klasifikim A

**Shenim: Ne rast pjesmarrjeje te nje Operatori ekonomik te huaj, ky i fundit, Licencen e mesiperme me kategorite e pershkruara, duhet ta kete te njehsuar prane organeve perkatese ne Republiken e Shqiperise sipas legjislacionit te saj ne fuqi.**

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale duhet te kete te punesuar te pakten 1 (nje) inxhinier elektrik dhe 1 (nje) inxhinier ndertimi.*

*Punonjesit e mesiperme duhet te jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig per 12 (dymbedhete) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.*

*Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: kontratat individuale te punes, shoqeruar me diplomat perkatese te inxhinierëve te mesiperme, deshmi IQT, si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet te dëshmoje se ka fuqinë punëtore të nevojshme minimalisht 8 (tete) punonjës me kohë të plotë pune, për realizimin e objektit të prokurimit. Punonjësit duhet te jene te siguruar te pakten për 12 (dymbedhete) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.*

*Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje listepagesat perkatese E-Sig.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete minimumi 3 (tre) punonjes, te pajisur me kartela personale te sigurimit teknik, nga te cilet 2 (dy) te jene punonjes me kategorine e sigurimit teknik IV-V, te leshuar nga shoqeri te akredituara ne baze te Ligjit Nr. 8734, date 01.02.2001 "Per garantimin e sigurise se punes te pajisjeve dhe te instalimeve elektrike", i ndryshuar.*

*Lidhur me kete pike, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje:*

- i. Listpagesat E-Sig te punonjesve te sipercituar si dhe*
- ii. Kartelat perkatese te vlefshme te sigurimit teknik.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

2.3.6 *Operatori ekonomik duhet të disponojë të pakten 2 (dy) specialistë të certifikuar për bashkim kabllorsh të tensionit të lartë dhe të pakten 2 (dy) specialistë të certifikuar për të punuar me terminalët 110 kV e sipër, ose të jete i mbështetur nga një kompani që i disponon këta specialistë.*

- *Kur specialistet disponohen nga operatori ekonomik të disponohet:*
  - I. *Listagesat E-Sig ku të figurojnë këta specialist dhe*
  - II. *Certifikatat e specialisteve*
- *Kur specialistet disponohen nga një kompani e tretë që mbështet OE ofertues, të disponohen:*
  - I. *Deklarata nga kompania mbështetëse për OE ofertues që këta specialistë i ve në dispozicion të OE për këtë projekt;*
  - II. *Certifikatat e specialisteve;*
  - III. *E-Sig ku të figurojnë këta specialist (Në rast se kompania mbështetëse është Shqiptare) ose Vetedeklarim që punonjësit janë të punësuar pranë kësaj kompanie (Në rast se kompania mbështetëse është e huaj).*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

2.3.7 *Operatori ekonomik ofertues për përmbushjen e kontratës duhet të dëshmojë se ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme, si më poshtë vijon:*

<b>Nr.</b>	<b>Mjetet</b>	<b>Sasia</b>
1	<i>Kamion me kapacitet mbi 3 ton</i>	<i>1 cope</i>
2	<i>Eskavator me kapacitet kove deri 0,5 m<sup>3</sup></i>	<i>1 cope</i>
3	<i>Makineri prerje asfalti (sharre me disk)</i>	<i>1 cope</i>
4	<i>Elektro/moto-betoniere jo me të vogël se 250 lit.</i>	<i>1 cope</i>
5	<i>Makineri diagnostikimi kabllorsh fuqie TL 110 kV</i>	<i>1 cope</i>

*Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të disponojë:*

1. *Për mjetet në pronësi të paraqitet akti i pronësisë (kontrata shitblerje, fatura tatimore e shitjes ose fatura e zhdoganimit etj.)*
2. *Për mjetet me qira të paraqitet kontratë qiraje si dhe akti i pronësisë së qiradhënësit sipas përcaktimit të bërë më lart.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që mallrat e furnizuara janë të reja (jo të rikonstruara).

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrata, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO, të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që kanë lidhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ✓ ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë.
- ✓ ISO 45001: për Sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë.
- ✓ ISO 14001: për Sistemin e menaxhimit mjedisor.

2.3.10 Për listën e mëposhtme të mallrave:

- ✓ Muftë bashkuëse për kabllot (sipas specifikimeve teknike)

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

1. Autorizim të prodhuesit/distributorit të autorizuar për listën e mesiperme të mallrave. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
2. Katalog/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit, për listën e materialeve të mesiperme që do të ofrohen, në të cilën të paraqiten të dhënat teknike baze të perkthyer në gjuhën shqipe.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë e katalogut, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera, të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi të kryera me pare, që vertetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mesiperme ose të ngjashme) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të plotësojë saktësisht kolonën me të dhënat teknike të ofertuar në të gjitha tabelat e paraqitura në Shtojcën 5 (Specifikimet teknike) të këtyre DT-ve, ku kërkohej.

**Mosplotësimi i saktë është element skualifikimi.**

2.3.12 Në funksion të plotësimit të Shtojcës 8 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemër, Ates, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuara të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoret e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posacem të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë, përfshirë ato teknike.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shënim:**

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë

---

*rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

- ii. *Ne plotesimin e “Formularit permbledhes te vetedeklarimit”, ne piken “Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, OE ofertues duhet te shenoje ne menyre te sakte, si prove paraprake: degen e studimeve te punonjesive, si dhe profilet perkatese te diplomave, qe disponon per plotesimin e kritereve te vecanta te kualifikimit. Keto deklarime do te shqyrtohen kur OE ofertues do te paraqese dokumentet origjinale ose kopje te noterizuara per punonjesit, pas shpalljes fitues se ofertes. Keqinformimi dhe deklarimi i rreme me qellim kualifikimin e ofertes, ne menyre te padrejte, sanksionohet nga pika 1/a, te nenit 78 “Perjashtimi per nje periudhe te caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik”, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.*

## Shtojca 8.

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

#### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none"><li><b>Informacione për nënkontraktorin</b></li></ul>
---

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e</p>

ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

## **B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”**

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;



4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
  - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
  - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
  - a) çmimet ;
  - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
  - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
  - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

### C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:  Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

